CREDINS BANK

Adresa Rruga Vaso Pasha nr.8
kodi postar 1019 Tiranë, Shqipëri

Tel +355 4 53 53 000
E-mail info@bankacredins.com

www.bankacredins.com

NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.

Për: Z/Znj._____(Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit _____)

Ju njoftojmë se *ditën e enjte datë 03 dhjetor 2026 ora 11:00* në ambientet e " BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do te zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Miratimi i riemërimit te zv. Drejtores së Përgjithshme të "Bankës Credins" sh.a. znj. Monika Milo.

2. Miratimi i shpërndarjes së fitimit të pashpërndare të vitit 2025, në shumën totale prej 500,000,000 (pesëqind milionë) lekësh, për aksionarët e "Bankës Credins" sh.a., sipas mënyrave të mëposhtme:

   a) te shperndahet dividendi nga fitimi i pashpërndare i vitit 2025 me mjete monetare për aksionarët të cilët zotërojnë më pak ose deri në 2% të kapitalit aksionar.
   - Aksionaret do të shprehin dakordësine me shkrim ose me e-mail per menyren e shperndarjes.
   - Ekzekutimi i vendimarrjes sa me siper do të jetë i varur nga permbushja dhe ecuria e treguesve të kapitalit rregullator.

   b) shuma e mbetur e fitimit te pashperndare qe ju takon aksionareve te cilet zotërojnë mbi 2% të kapitalit aksionar, do te kaloje në kapitalin e "Banka Credins" sh.a.,

3. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatese në përputhje me kerkesat Ligjore dhe rregullatore .

Jeni të lutur të paraqiteni.

Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

CREDINS BANK
ZYRA QËNDRORE 1212-00
TIRANË - SHQIPËRI

Tiranë më 12.11.2026

NUIS K31608801O
Swift CDISALTR

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me ketë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkese me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.